



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

LICENCË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

DHËNË:

KORPORATËS ENERGETIKE TË KOSOVËS SH.A

Divizioni i Shpërndarjes

Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li_06/12



PËRMBAJTJA

KREU I: TERMAT E LICENCËS.....	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS	4
Neni 1: Përkufizimet.....	4
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Shpërndarjes.....	5
Neni 3: Taksat, Ngarkesat dhe Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve	6
Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes, dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji	6
Neni 5: Funkionimi i Sistemit të Shpërndarjes	6
Neni 6: Plani Zhvillimor	7
Neni 7: Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve	7
Neni 8: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante	7
Neni 9: Furnizimi me Pajisje Matëse dhe Shërbimet e të Dhënave.....	8
Neni 10: Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar i Energjisë Elektrike.....	9
Neni 11: Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes.....	9
Neni 12: Standardet e Sigurisë së Operimit	10
Neni 13: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes së aktiviteteve të Operatorit të Shpërndarjes.....	10
Neni 14: Qasja në Tokë dhe/ose në Ndërtesa	11
Neni 15: Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar.....	11
Neni 16: Dhënia e Informatave Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorëve tjerë të Sistemit të Shpërndarjes.....	12
Neni 17: Informimi i Konsumatorëve	12
Neni 18: Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	12
Neni 19: Rregullat e Tregut	13
Neni 20: Shëndeti dhe Siguria	13
Neni 21: Puna	13
Neni 22: Obligimi i Sigurimit.....	13
Neni 23: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	13
Neni 24: Obligimet e Shërbimit Publik	14
Neni 25: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së	14
Neni 26: Vazhdimi, Modifikimi Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	14
Neni 27: Masat Administrative dhe Gjobat	15
Neni 28: Zgjidhja e Kontesteve.....	15



KREU I TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje “ZRRE”)**, në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185), Nenin 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184), dhe Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L-201) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë, dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës për caktimin e Korporatës Energjetike të Kosovës (“KEK Sh.A.”) si operator i vetëm rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, **i modifikon Korporatës Energjetike të Kosovës SH.A.-Divizionit të Shpërndarjes (tani e tutje “i Licencuari”) Licencën për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.**
2. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
3. Të Licencuarit mund të mos i jepet licenca për ndonjë aktivitet tjetër të energjisë elektrike, në pajtim me Nenin 46.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, me kusht që ndonjë anëtare e të licencuarit mund të pajiset me licencë për aktivitetet tjera të energjisë elektrike në përputhje me kërkesat relevante të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjit për Energjinë Elektrike.
4. I licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me Nenet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
5. I licencuari do të veprojë si vijon:
 - 5.1. operojë me sistemin e shpërndarjes në mënyrë efikase, ekonomike dhe të koordinuar siç është përcaktuara me këtë licencë;
 - 5.2. sigurojë disponueshmëri afatgjate të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarje të energjisë elektrike, për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin sipas kushteve të tregut, duke i kushtuar kujdes të duhur mjedisit dhe efikasitetit të energjisë;
 - 5.3. ofron kyçjet dhe shfrytëzimin e sistemit në mënyrë jodiskurminuese në pajtueshmërinë me ligjet, kodet dhe rregullat në fuqi;
 - 5.4. nxisë zbatimin e Rregullave të Tregut.
6. Licenca vlen nga data **04 Tetor 2006** dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri me **04 Tetor 2036** me mundësi vazhdimi, në pajtim me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
7. Në pajtim me Nenin 34 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë e modifikon licencën për operatorin e sistemit të shpërndarjes me numër licence ZRRE/Li_06/06 e lëshuar me datë 04 tetor 2006 nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe hynë në fuqi me datë **18.07.2012.**

E Vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë: _____.
Nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së): _____.



KREU II: KUSHTET E LICENCËS

Neni 1: Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptim si në vijim:

"Anëtar" - marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës i ndonjë ndërmarrje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.

"Program i Pajtueshmërisë" – programi që kërkohet të përgatitet nga ana e të Licencuarit dhe i cili do të aprovohet nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Plan Zhvillimor" - çdo plan zhvillimor që do të përgatitet nga i Licencuari, sipas Nenit 7 të Ligjit për Energjinë dhe nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Standarde të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes" - dokumenti që do të përgatitet nga i Licencuari në përputhje me Nenin 11 të kësaj Licence.

"Vit financiar" - periudha prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

"Kompani Aksionare" - çdo kompani e definuar si e tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

"Legjislacion" - Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L - 201) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

"Rregulla të Tregut" - rregulla të miratuara nga ZRRE që përcaktojnë funksionimin e tregut së energjisë elektrike dhe raportet në mes të Operatorit të Tregut dhe pjesëmarrësve në treg, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

"Kode"- rregullat teknike të nxjerra nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të aprovuara nga ZRRE-ja, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

"Vartës" - çdo kompani në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

2. Termet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.



Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Shpërndarjes

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare vjetore në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara, brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme duhen të jenë të ndara për aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga llogaritë e tjera të tij për aktivitetet tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër.
2. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditor i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
3. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në tërësi, dhe sipas kërkesës së ZRRE-së, do t'i dorëzohet në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, i cili ndër të tjerash mund të specifikojë:
 - 3.1 formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis bizneseve të konsoliduara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ndonjë biznesi tjetër.
 - 3.2 natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara.
 - 3.3 parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Nenit 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe ti ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që të veproj në përputhje me ato kërkesa me qëllim që të garantojë pavarësinë e tij.
6. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe legjislacioni në fuqi.



Neni 3: Taksat, Ngarkesat dhe Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve

1. Të gjitha taksat dhe ngarkesat që do të mblidhen nga i Licencuari për kryerjen e aktiviteteve të dhëna me licencë, duhet të vendosen në përputhje me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Metodologjinë e Taksave për Kyçje të aprovuara nga ZRRE-ja.
2. I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që nga aktiviteti i shpërndarjes të japë apo të marrë ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi apo anëtar, dhe/ose nga ndonjë person tjetër.

Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes, dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit, Kodet e Matjes, dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e atyre dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 5: Funkionimi i Sistemit të Shpërndarjes

1. I Licencuari është përgjegjës për funksionimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari është i obliguar të ofrojë afatet për kyçje dhe përdorimin e sistemit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji. Për çdo kontest që del nga kyçja apo përdorimi i sistemit të Shpërndarjes, do të zbatohet Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
3. I Licencuari do të siguroj qasje jo diskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit ose kategoritë e shfrytëzuesve të sistemit, në veçanti duke mos i favorizuar Vartësit apo Aksionarët, dhe t'u siguroj atyre informatat që ju nevojiten për qasje efikase në sistem, në përputhje me Nenin 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
4. I Licencuari do të publikojë në faqen zyrtare elektronike të tij Metodologjinë Tarifore për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Metodologjinë e Taksave për Kyçje, të aprovuar nga ZRRE-ja.



Neni 6: Plani Zhvillimor

1. Në përputhje me Nenin 7 të Ligjit për Energjinë dhe Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike, i Licencuari do të hartojë dhe publikojë Planin Zhvillimor afatmesëm dhe afatgjatë të Sistemit të Shpërndarjes, që mbulojnë periudha prej së paku tri (3) vite respektivisht dhjetë (10) vite. Plani zhvillimor duhet të jetë në dispozicion të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të dorëzohet në ZRRE për aprovim.
2. I Licencuari do të rishikojë planin zhvillimor afatgjatë çdo vit, në mënyrë që informacioni i paraqitur në planin zhvillimor, të vazhdojë të jetë i saktë në të gjithë aspektet materiale. Propozimet eventuale për plotësimin apo ndryshimin e planit zhvillimor do të dorëzohen në ZRRE-së për aprovim.

Neni 7: Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve

1. I Licencuari do të kontraktojë dhe sigurojë asetet dhe shërbimet që janë të nevojshme për t'i mundësuar atij që të kryejë detyrimin e tij sipas Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Shpërndarjes. Kontraktimet e tilla do të bëhen në përputhje me Ligjin për prokurimin publik, dhe legjislacionin tjetër relevant në fuqi në Kosovë.
2. Gjatë kontraktimit për sigurimin e asetëve dhe shërbimeve në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, i Licencuari do të blejë ose do të sigurojë në ndonjë formë tjetër ato asete dhe shërbime nga burimet më ekonomike që ka në dispozicion.
3. Duke marr parasysh burimet më ekonomike që ka në dispozicion, i Licencuari duhet të ketë parasysh sasinë, natyrën, shumëllojshmërinë, numrin dhe sigurinë e asetëve të tilla dhe shërbimeve që në atë kohë kanë qenë në dispozicion për blerje ose për përvetësim tjetër, dhe sipas nevojave të tij që t'i mundësojë atij që t'i kryej obligimet e tija sipas kësaj licence, Kodit të Shpërndarjes dhe Legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 8: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mbajë një regjistër të të gjithë asetëve relevante dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së me çdo ndryshim në regjistër jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do ta shes apo heq dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë e tij për të kryer obligimet e tij. Në rast kur i Licencuari dëshiron të shes asetet, apo pasuritë tjera që përdoren në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, ku vlera e tyre tejkalon shumë (njëqind mijë euro) 100,000.00 €, i Licencuari do të obligohet që ta njoftoj ZRRE-në me shkrim. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti të tillë vetëm pas miratimit me shkrim nga ZRRE-ja.
3. Në këtë Nen:



"Tjetërsim" – çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë ngarkesë tjetër si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një aktivitetit tjetër të të Licencuarit ose pale të tretë.

"Aset relevant" nënkupton:

- a) çdo pajisje e Sistemit të Shpërndarjes që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet e veta siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij Neni;
- b) çdo interes ligjor ose përfitues mbi tokën dhe/ose ndërtesat në të cilat janë vendosur të sipërpërmendurit, dhe/ose që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet që përcaktohen në këtë Licencë; dhe
- c) çdo e drejtë pronësore përkatëse intelektuale.

Neni 9: Furnizimi me Pajisje Matëse dhe Shërbimet e të Dhënave

1. I licencuari në përputhje me Nenet 31 dhe 32 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes së OSSH-së dhe Rregullat e Tregut, dhe sipas kërkesës së konsumatorëve, Furnizuesit dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit, do të siguroj këto shërbime:

- 1.1. furnizimin me Pajisje Matëse;
- 1.2. instalimin, matjen, testimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e Pajisjeve Matëse;
- 1.3. shërbimet për grumbullimin e të dhënave;
- 1.4. transferin e të dhënave, procedimin e të dhënave dhe shërbimet e grumbullimit të të dhënave.

2. I Licencuari do të bëj të gjitha përpjekjet për të siguruar leximin e njehsorit në secilin objekt të specifikuar ose përshkruar në udhëzimin nga furnizuesi i burimit tëi fundit, brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve të këtij njoftimi.

3. I Licencuari mund t'ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast i Licencuari do të sigurohet se entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve, është i detyruar të kryej lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin Matës të OSSH-së.

4. ZRRE-ja mund të kërkoj nga i Licencuari të grumbulloj dhe mbaj informata, të dhëna dhe dokumente në përputhje me Nenin 28 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Në këtë Nen:

"Shërbimet e të dhënave" - shërbimet e mbledhjes së të dhënave, procesimit të të dhënave, grumbullimi i tyre dhe furnizimi me të dhëna;

"Transferi i të dhënave" - transferimin e të dhënave të papërpunuara dhe të dhënave të përpunuara mbi matjet tek ndërmarrje tjera të licencuara për energji, aq sa kërkohen për llogaritjet përfundimtare dhe për qëllime të faturimit;



“Përpunimi i të dhënave” - shërbime që përmbajnë shqyrtimin, vlefshmërinë, vlerësimin e të dhënave nga leximi i njehsorit në lidhje me konsumimin e energjisë elektrike në ndërtesat që furnizohen me energji elektrike përmes njehsorit, dhe krijimin, shqyrtimin dhe vlefshmërinë e të dhënave në lidhje me konsumimin e energjisë elektrike në ndërtesat që nuk furnizohen me energji elektrike përmes njehsorit; dhe

“Grumbullimi i të dhënave” - mbledhjen e të dhënave nga leximi i njehsorëve, krahasimi (sistemimi) dhe dërgimin e këtyre të dhënave te Operatori i Tregut.

Neni 10: Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar i Energjisë Elektrike

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të Identifikimit dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, dëmtimi të ndonjë pajisje apo njehsori dhe shkeljeve tjera të përcaktuara me Nenin 39 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
2. I Licencuari është i obliguar të zbatojë Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe do të ndërmerr masat parandaluese për të mbrojtur të hyrat e OSSh-së.
3. Me kërkesë të Licencuarit apo të ZRRE-së, Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike mund të ndërrohet (plotësohet) kohë pas kohe, por ndryshimet (plotësimet) duhet të aprovohet nga ZRRE.

Neni 11: Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes

1. I Licencuari, brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e aprovimit të modifikimit të kësaj licence, të do hartojë Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes dhe do t'i dërgojë në ZRRE për aprovim.
2. I Licencuari do të jetë përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Shpërndarjes, dhe nëse është e nevojshme, edhe zhvillimin e tij në përputhje me Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe me standarde të tjera të planifikimit dhe operimit të cilat i Licencuari mund t'i zbatoj, pas aprovimit nga ZRRE.
3. I Licencuari do të shqyrtojë kohë pas kohe zbatimin e Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes, dhe do të dorëzojë në ZRRE:
 - 3.1 një raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
 - 3.2 propozimin për amendamentim eventual të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes.



4. I Licencuari do të publikojë në faqen elektronike zyrtare të tij, Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes.
5. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa pjesëve të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë ose refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 12: Standardet e Sigurisë së Operimit

1. I Licencuari brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e aprovimit të modifikimit të kësaj licence, do hartoj Standardet e Sigurisë së Operimit dhe do të dorëzojë në ZRRE për aprovim.
2. I Licencuari do t'i zbatoj Standardet e Sigurisë së Operimit dhe do të jetë përgjegjës për funksionimin e sistemit të shpërndarjes në përputhje me këto Standarde.
3. I Licencuari do ti rishqyrtoj herë pas here Standardet e Sigurisë së Operimit si dhe zbatimin e tyre, dhe do të dorëzojë në ZRRE:
 - 3.1. raportin mbi rezultatet e rishqyrtimit të tillë, dhe
 - 3.2. ndryshimet që propozohen ti bëhen Standardeve të Sigurisë së Operimit.
4. ZRRE-ja mund të nxjerri udhëzime me të cilat kërkon nga i Licencuari që ti ripunoj Standardet e Sigurisë së Operimit në atë mënyrë që do të specifikohet në ato udhëzime, dhe i Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me ato udhëzime.
5. I Licencuari do ti publikoj në faqen elektronike zyrtare të tij Standardet e Sigurisë së Operimit.

Neni 13: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes së aktiviteteve të Operatorit të Shpërndarjes

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike të aprovuar nga ZRRE-ja.
2. Kur ZRRE kërkon, apo kur i Licencuari e konsideron si të arsyeshme, i Licencuari do të shqyrtojë standardet ekzistuese të përgjithshme dhe minimale të përmbushjes dhe brenda afatit të përcaktuar nga ZRRE.
3. I Licencuari do të zbatoj standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurat e monitorimit të përmbushjes së standardeve të cilësisë dhe furnizimit dhe shërbimit. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.



4. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 31 Mars të çdo viti kalendarik raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përmbushjen e standardeve sipas këtij Neni.
5. I Licencuari deri me 31 Mars të çdo viti kalendarik do të publikojë statistikën ashtu si ZRRE-ja i kërkon, lidhur me përmbushjen ose mos përmbushjen e standardeve të përcaktuara sipas këtij Neni.

Neni 14: Qasja në Tokë dhe/ose në Ndërtesa

1. I Licencuari do të zbatojë Kodin e Punës i cili përcakton parimet dhe procedurat që do të ndjekë në lidhje me ndonjë person që vepron në emër të të Licencuarit dhe që kërkon qasje në tokë dhe/ose ndërtesë e që lidhet me ushtrimin e aktivitetit të licencuar.
2. Kodi i Punës do të përfshijë procedurat për të siguruar që personi që kërkon qasje në tokën dhe/ose ndërtesën, në emër të të Licencuarit:
 - 2.1. posedon aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara;
 - 2.2. mund të identifikohet nga publiku, dhe
 - 2.3. janë persona të autorizuar për të vizituar dhe hyrë në tokat apo ndërtesat.
3. I Licencuari do të rishqyrtojë kohë pas kohe Kodin e Punës dhe çdo ndryshim i këtij Kodi të Punës do t'i nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.

Neni 15: Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar

1. I Licencuari, aty ku është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve të licencuara, do të zbulojë çdo informacion, përveç atyre informatave konfidenciale, që i mbanë dhe/ose i ka siguruar gjatë kryerjes së funksioneve të veta si Operator i Sistemit të Shpërndarjes. Pavarësisht nga kjo, i Licencuari do t'i ofrojë çdo informatë ZRRE-së që ajo mund t'i kërkojë në kryerjen e obligimeve që i janë dhënë me Legjislacionin në fuqi dhe Nenin 25 të kësaj Licence.
2. I Licencuari do të sigurojë që çdo dokument që përmban informacione konfidenciale (të fshehta), duhet ta bëjë identifikimin e qartë të informacionit si konfidencial (ta shënjojë si informatë konfidenciale).
3. I Licencuari do të marrë masat e parapara për të parandaluar zbulimin e informacioneve konfidenciale nga çdo person dhe këto informata nuk mund të përdoren apo zbulohen për ndonjë qëllim tjetër nga ajo që është dhënë sipas dispozitave përkatëse të ligjeve në fuqi.



Neni 16: Dhënia e Informatave Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorëve tjerë të Sistemit të Shpërndarjes

1. Në mënyrë që të sigurojë funksionim efikas, zhvillim të koordinuar dhe ndër funksionim të sistemeve të ndërlidhura, i Licencuari do t'i dërgojë çdo informatë të domosdoshme Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorëve tjerë të Sistemit të Shpërndarjes, në atë mënyrë dhe në ato kohë që me arsye mund të jetë kërkuar nga këta operatorë.
2. Në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti në mes të Licencuarit dhe ndonjë pale tjetër, i Licencuari do të procedojë në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE.

Neni 17: Informimi i Konsumatorëve

1. I Licencuari do t'i mbajë të informuar konsumatorët e vet (përveç nëse konsumatori furnizohet me energji vetanake që nuk kalon nëpërmes njehsorit) për sasinë e energjisë elektrike, që është regjistruar si e harxhuar nga ai konsumator sipas njehsorit (matësit) përmes të cilit konsumatori është furnizuar.
2. I Licencuari do t'i mbajë të informuar konsumatorët e vet mbi procedurën për zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, si dhe rolin e ZRRE-së në zgjidhjen e kontesteve të tilla.
3. I Licencuari do t'i kryejë detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij Neni duke siguruar informatën relevante për secilën faturë apo deklaratë që i është dhënë konsumatorit në lidhje me detyrimet për furnizim me energji elektrike.

Neni 18: Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. I Licencuari në përputhje me Nenin 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike do të hartojë programin e pajtueshmërisë i cili përcakton masat të cilat duhet të ndërmerren për shthurjen e bizneseve të shpërndarjes nga strukturat e integruara e KEK-ut sa i përket formës ligjore, organizimit dhe vendimmarrjes. ZRRE miraton programin e tillë.
2. Programi i referuar në paragrafin 1 të këtij Neni gjithashtu do të përcaktojë masat për eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe do të sigurojë që programi të monitorohet në mënyrë adekuate.
3. Programi do të përcaktojë detyrimet specifike të punonjësve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për arritjen e objektivave të përmendura më lartë. Një raport vjetor publik i cili përshkruan masat të cilat janë ndërmarrë do të dorëzohet nga personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë në Zyrën e Rregullatorit për Energji.



4. I Licencuari do të publikoj Programin e Pajtueshmërisë në faqen zyrtare elektronike të tij.

Neni 19: Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të veprojë në pajtim me Rregullat e Tregut në fuqi.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa dispozitave të Rregullave të Tregut. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 20: Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat nga lëndimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll (auditim) teknik dhe të sigurisë të sistemit të shpërndarjes në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë, do t'i dërgojë në ZRRE, sa herë që kjo kërkohet nga ZRRE-ja

Neni 21: Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 22: Obligimi i Sigurimit

1. I licencuari do të bëjë sigurimin e aseteve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I licencuari do të lidhë kontrata për sigurimin e aseteve të sistemit të shpërndarjes dhe për pajisjet që përdoren për shpërndarje të energjisë elektrike. Kontrata e tillë do t'i dërgohet ZRRE-së për rishikim në baza vjetore.

Neni 23: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon atë.



2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 24: Obligimet e Shërbimit Publik

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimeve publike që mund t'i vendoset nga ZRRE-ja, sipas Nenit 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 25: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë ZRRE-së informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. I Licencuari do ti dërgoj ZRRE-së raporte tremujore dhe vjetore me të cilin informon mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe pajtueshmërinë me kushtet e Licencës sipas Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja .
3. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullin për Informatat Konfidenciale, kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënoj atë informacion si konfidencial dhe të arsyetoj kërkesën e tij te ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. Zyra e Rregullatorit për Energji ka të drejtë të kërkojë nga I licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. I Licencuari duhet t'i dërgojë ZRRE-së detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguara gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacioni" - materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 26: Vazhdimi, Modifikimi Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e



Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke u siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 27: Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE apo Nenet dhe kushtet e kësaj Licence apo instruksioneve dhënë të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca të vendosë të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 28: Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.